



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr.2004/12

Prishtinë, më 28,29 dhe 30 korrik 2004

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 64 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për detyrimet;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trashëgiminë;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për koncesionet;
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara;
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryeshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet;
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shpalljen e kompleksit memorial "Adem Jashari" me interes të veçantë nacional;
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen e investimeve në Kososvë;
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimtarinë blegtorale;
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inspeksionin e arsimit;
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër korrupsionit;
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lojërat e fatit;

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësit e qytetarëve në kujdesin shëndetsor;
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje civile dhe gatishmëri emergjente;
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për avokatinë;
18. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Gjqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e prokurorëve dhe gjykatësve
19. Shqyrtimi i informatës për kërkimin e personave të zhdukur dhe të kidnapuar.

Në fillim të seancës, deputeti **Bajrush Xhemajli**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozoi të shtyhet për seancën e ardhshme shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen e investimeve, ngase Qeveria e Kosovës kishte kërkuar një gjë të tillë dhe ishte duke hartuar një Projektligj të kësaj fushe. Sponsoruesi i këtij projektligji dhe Ministria e Tregtisë dhe e Insustrisë duhet t'i harmonizojnë qëndrimet deri në seancën e ardhshme lidhur me këtë projektligj.

Deputeti **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e mbështeti propozimin e deputetit Bajrush Xhemajli.

Kryetari propozoi të radhitë në rend dite të kësaj séance edhe shqyrtimet e panelit të vaçantë lidhur me Ligjin për shëdetësi dhe Ligjin kundër diskriminimit.

Kuvendi e miratoi rendin e ditës të kësaj séance me propozimet e dy grupeve parlamentare dhe të kryetarit të Kuvendit.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Gjqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me procedimin e amendamenteve në Kornizën Kushtetuese

Kryetari e ftoi Fatmir Sejdiun ta arsyetonte rekomandimin e Komisionit Legjislativ.

Fatmir Sejdiu tha se Komisioni dhe Grupi i Punës kanë bërë përpjekje që të vazhdojnë me harmonizimin e atyre amendamenteve sipas rekomandimit të Kuvendit. Ne jemi në proces e sipër, mirëpo ky rekomandim që është dhënë nga Grupi i Punës dhe Komisioni për Legjislacion janë të mendimit se amendamentet e miratuara i konsiderojmë si të përfunduara dhe të procedohet për këtë më tej. Pjesa e mbetur do të jetë pjesë që do bëhet në procesin e ardhshëm dhe një fazë të ardhshme të prezentohen para Kuvendit.

Gani Sadik, në emër të Grupit Parlamentar të të tjerëve, tha se lëshuarja e seancës së mëparshme të këtij grupi kur u votuan amendamentet për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese ishte një mosmarrëveshje. Ne i përkrahim ato ndryshime dhe

pltesime në Kornizën Kushtetuese dhe në asnjë mënyrë nuk do të ndahemi prej shqiptarëve dhe prej krejt popullit të Kosovës.
Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi nxori këtë

Përfundim:

Kuvendi i Kosovës, njëzëri i miratoi rekomandimet e Komisionit Legjislativ lidhur me procedimin e amendamenteve në Kornizën Kushtetuese.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për detyrimet

Kryetari i informoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.
I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e deputetës Nerxhivane Dauti të përkrahura nga Komsini FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi amendamentet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18.
Kryetari hodhi në votë amendamentet prej 19 deri 33, në tërësi.
Kuvendi njëzëri i miratoi amendamentet prej 19 – 33.

Kryetari e hodhi në votë Projektgjinn në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 64;
Kundër-----0;
Abstenime---0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për detyrimet.

4. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për trashigiminë

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e deputetës Nekibe Kelmendi dhe të deputetit Mehdi Bardhi.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32 dhe 33.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet 15, 18 dhe 21.

Kryetari e hodhi në votë Projektgjinn në tërësi. Rezultat ishte si vijon:

Për----- 64;
Kundër-----0;

Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për trashëgiminë.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konsensionet

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit Funkcional lidur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Tregti dhe Industri dhe të Komisionit për Buxhet.

Kuvendi i miratoi këto amendamente:1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17,18, 19, 20,21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31.

Kryetari e hodhi në votë Prjektligjin në tërësi. Rezultat ishte si vijon:

Për----- 74;
Kundër-----1;
Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për koncensionet.

Kryetari dha pauzë gjysëmorëshe.

Pas pauzës seancën e drejtoi **Hydajet Hyseni**, anëtar i Kryesisë.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmueshme

Kryesuesi i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit Funkcional lidur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Tregti dhe Industri.

Kuvendi i miratoi këto amendamente:1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17,18, 19, 20,21, 22 dhe 23.

Kryesuesi e hodhi në votë Prjektligjin në tërësi. Rezultat ishte si vijon:

Për----- 64;
Kundër-----0;
Abstenime---0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për punimet nga metalet e çmueshme.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet

Kryesuesi i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidur me këtë projektligj.

Meqë askush nuk kishte paraqitur amendamente, **kryesuesi** e hodhi në votë Projektligjin në fomë e propozuar. Rezultati ishte si vjon:

Për----- 64;
Kundër----- 0;
Abstenime--- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Kryesuesi i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, vec e vec, amendamentet e Komisionit për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe të Komisionit për Buxhet.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29b, 30, 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultat ishte si vijon:

Për----- 65;
Kundër-----0;
Abstenime----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Vazhdim i seancës më 29 korrik 2004

Seancën e drejtoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit. Ishin të pranishëm 71 deputetë.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shpalje e kompleksit memorial "Adem Jashari" me interes të veçantë nacional

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Nerxhivane Dauti, në emër të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, tha se me këtë projektligj krijohet baza ligjore për institucionalizimin e kompleksit “Adem Jashari” dhe ngritjen e tij në nivel të tempullit nacional.

Me këtë projektligj përcaktohet statusi i kompleksit përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz, kujdesi ndaj tij, mbrojtja nga ndikimet politike dhe detyrimet e institucioneve të Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji është shpallja e kompleksit “Adem Jashari” zonë me interes të veçantë nacional për Kosovën.

Sipas këtij projektligji kompleksi përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz ka rëndësi ontologjike, antropologjike, historike, kulturore e qytetare për Skenderajn, Drenicën, Kosovën dhe tërë kombin shqiptar.

Duke e ngritur në nivel të institucionit nacional, Projektligji ndalon shprehimisht politizimin e tij, duke ndaluar tubimet dhe manifestimet partiake brenda hapësirës së tij.

Në përfundim të arsyetimit, deputetja Nerxhivane Dauti i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Pas këtij arsyetimi, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinionet, vërejtje dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe këta deputetë: **Alush Gashi, Berat Luzha, Gani Sadik, Bujar Dugoli, Fadil Geci, Edi Shukriu dhe Ramush Haradinaj**, që i janë ashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji në parim. Rezultati ishte si vjon:

Për----- 71;

Kundër-----0;

Abstenime---0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për shpaljen e kompleksit memorial “Adem Jashari” me interes të veçantë nacional. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin Legjislativ – Komision raportues – ta shqyrtojë këtë projektligj brenda afatit të përcaktuar dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime për miratim.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimtarinë blegtorale

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Et’hem Çeku, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se Projektligji për prodhimtarinë blegtorale paraqet rregulla dhe standarde në sektorin e blegtorisë të cilin e

përafrojnë këtë sektor me strukturën ligjore të Bashkësisë Evropiane, duke marrë në konsideratë implikimet e mundshme sociale dhe ekonomike.

Ky projektligj ka për qëllim të krijojë bazën ligjore për çështje që konsiderohen të rëndësishme dhe me prioritet nga lëmia e blektorisë, siç janë: mbarsja e kafshëve, ushqimi i kafshëve, standardet e kualitetet dhe klasifikimi i produkteve blektorale të prodhuara në fermë dhe të cilët i shiten industrisë përpunuese si dhe standardet zooteknike për zhvillimin e blektorisë.

Prodhimtaria blektorale në Kosovë aktualisht është e orientuar në rritjen e gjedheve për qumësht dhe atyre për prodhimin e mishit, të kafshëve të imta për mish apo për qumësht, si dhe mbajtjen e shpezëve.

Ligji aktual i blektorisë daton nga viti 1974 dhe nuk është më ai i aplikueshëm në sistemin e ekonomisë së tregut në Kosovë, pikërisht për shkak të ndryshimeve të përgjithshme ekonomike. Kjo ka bërë që të krijohet një zbrastësi e cila rezulton me zvogëlimin e produktivitetit të prodhimit si dhe mungesën e kontrollit të mbarsjes së kafshëve, të ushqimit dhe kualiteteve të prodhimeve ushqimore.

Projektligji për prodhimtarinë blektorale përmban pesë kapituj.

Në kapitullin e parë, janë përfshirë dispozitat që kanë të bëjnë me mbarsjen.

Në kapitullin e dytë, rregullohet ushqimi i kafshëve si dhe aditiva që përfshinë materialin ushqimor blegtoral të regjistruar.

Në kapitullin e tretë, përfshihen dispozitat që përcaktojnë standardet e cilësisë.

Në kapitullin e katërt rregullohen standardet zooteknike në sektorin e blektorisë.

Në kapitullin e pestë përfshihen dispozitat ndëshkimore, sipas të cilëve është përcaktuar qartë zbatimi përmes kontrollit dhe sanksioneve.

Në përfundim të arsyetimit, ministri Çeku i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratojnë këtë projektligj.

Pas arsyetimit të ministrit Çeku, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe këta deputetë: **Sebahate Krasniqi, Tomë Hajdaraj, Berat Luzha, Hasan Meta dhe Mehdi Bardhi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji në parim. Rezultati ishte si vijon:

Për-----70;

Kundër-----0;

Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për prodhimtarinë blektorale. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për

Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inspeksionin e arsimit

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Rexhep Osmani tha se arsyet e nxjerrjes së këtij ligji janë reformat në fushën e arsimit, të cilat janë duke ecur me një ritëm shumë të mirë. Mirëpo, shtrohet nevoja e aftësimit të stafit menaxhues të arsimit. Kjo na ka obliguar që të ngrisim një staf inspektues. Stafi inspektues do të përcjellë respektimin e ligjshmërisë në të gjitha nivelet arsimore.

Format e një kontrolli të përhershëm për rrjedhat e sistemit shkollor, qofshin ato në kompetenca të sistemit publik apo privat, kushtëzojnë zbatimin e ligjshmërisë. Në këtë përkushtim është vënë në përpilim edhe Projektligji i inspeksionit të arsimit i Kosovës, i cili mundëson krijimin e kushteve për funksionimin e rregullt dhe ligjor të procesit edukativo-arsimor në Kosovë.

Me këtë projektligj parashihet mbikëqyrja në zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore në fushën e edukimit dhe të arsimit publik e privat, për edukimin dhe arsimin parashkollor, arsimin fillor, të ulët e arsimin e mesëm, të lartë, arsimin e lartë universitar, arsimin special, aftësimin profesional dhe strehimet e organizuara të fëmijëve, të nxënësve e të studentëve, çerdhet e fëmijëve dhe konviktet e nxënësve dhe të studentëve dhe arsimin në diasporë.

Projektligji përmban tre kapituj, në të cilët përfshihen: dispozitat e përgjithshme, dispozitat ndëshkuese dhe dispozitat kalimtare.

Me dispozitat e përgjithshme rregullohen çështjet, si: qëllimi, fushëveprimi, organizimi e tjera.

Inspeksioni i arsimit është organ ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës e të Teknologjisë.

Inspeksionin e arsimit e përbëjnë: Inspektori i përgjithshëm, zyrtarët e zyrave të inspektimit, inspektorët e zyrave rajonale të arsimit.

Inspektori i arsimit kontrollon, inspekton dhe nxjerr vendime meritore në përputhje me rregullativën ligjore për të gjitha çështjet dhe rastet kontestuese në institucionet arsimore; inicon ngritjen e procedurave adekuate administrative në mbrojtje të ligjshmërisë dhe rregullsisë në funksionimin e institucioneve të arsimit.

Dispozitat ndëshkuese do të ndërmirren në rast të moszbatimit të këtij ligji.

Dispozitat kalimtare përfshijnë të drejtën e Ministrisë për nxjerrjen e udhëzimeve administrative, shfuqizimin e dispozitave të mëparshme në këtë fushë dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Në përfundim të arsyetimit, ministri Osmani i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Pas arsyetimit të ministrit Osmani, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Alush Gashi, në emër të Grupi Parlamentar të LDK-së dhe të përkrahur edhe nga grupet parlamentare të PDK-së dhe të AAK-së, tha se përfaqësuesit e institucioneve demokratike të shumicës së shqiptarëve në Luginën e Preshevës na janë drejtuar për ndihmë lidhur me shkollim universitar.

Duke e kuptuar të drejtën e shkollimit, si një nga të drejtat themelore të njeriut, Kuvendi i Kosovës e miraton këtë

DEKLARATË

1. Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës, që në kuadër të aktivitetit të saj ndërkombëtar, të kërkojë nga bashkësia ndërkombëtare dhe Qeveria e Serbisë që shqiptarët e Luginës së Preshevës ta kenë Universitetin në gjuhën shqipe;
2. Deri në realizim të kësaj të drejte themelore, kërkojmë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë t'ua mundësojë studentëve nga Lugina e Preshevës të regjistrohen në Universitetin e Prishtinës.

Kryetari e hodhi në votë deklaratën e paraqitur nga deputeti Alush Gashi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----71;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi deklaratën e paraqitur, në emër të tri grupeve parlamentare, nga deputeti Alush Gashi.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për inspeksionin e arsimit.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe këta deputetë: **Niman Alimusa, Drita Statovci, Bujar Dugolli, Gjylshene Berisha, Muhamet Kelmendi, Fetije Këpuska, Hasan Meta, Zyhrije Maloku, Ramadan Kelmendi dhe Remzije Nimani**, që i janë bashkangjitur transkriptit. Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji në parim. Rezultati ishte si vijon:

Për-----68;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për inspeksinin e arsimit. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komision për Arsim, Shkencë dhe Teknologji – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër korrupsionit

Kryetari e ftoi sponsoruesin që ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit këtë projektligj.

Ministri Jakup Krasniqi: Rëndësia e këtij projektligji është në faktin se ky është pjesë e strategjisë legjislative të Qeverisë së Kosovës dhe e planit për implementimin e standardeve për Kosovën.

Projektligji kundër korrupsionit është hartuar në tri shtylla kryesore:

- Baza legjislative e sanksionimit në norma;
- Baza ekzekutive që nënkupton themelimin e Agjencisë kundër korrupsionit dhe
- Harmonizimi i këtij projektligji me normat dhe standardet ndërkombëtare e posaçërisht me ato të Bashkimit Evropian.

Ky projektligj përbëhet tetë kapituj dhe 55 nene.

Në kreun e parë, përfshihen dispozitat e përgjithshme; përkufzimi i nocioneve; ndalimi i keqpërdorimit të pozitës dhe të detyrës zyrtare, si dhe pavlershmëria e punëve juridike që rrjedhin nga korrupsioni.

Në kreun e dytë, parashihet themelimi i Agjencisë së Kosovës kundër korrupsionit, mënyra e udhëheqjes së saj; mënyra e zgjedhjes dhe e shkarkimit të bashkëdrejtorëve; përfaqësimi i Agjencisë; obligimi i organeve publike; autoriteteve lokale, si dhe personave zyrtarë për të bashkëpunuar me Agjencisë përkitazi me inspektimin e dokumentacionit relevant.

Në kreun e tretë, rregullohen rastet e konflikteve të interesave të personave zyrtarë; pamundësinë e ushtrimit të funksioneve të tjera që janë në inkompatibilitet me funksionet e tyre.

Në kreun e katërtë, rregullohen ndalimi i personave zyrtarë në pranimin e dhuratave, përveç atyre formale dhe dhuratave të rastit me vlerë të vogël.

Në kreun e pestë, rregullohet mbikëqyrja e pasurive të personave të lartë zyrtarë dhe e personave që janë në marrëdhënie të afërtë me ta në bazë të informatave të dhëna prej tyre

Në kreun e gjashtë, rregullohet obligimi i personave të punësuar në Agjenci për t'i ruajtur si sekret informacionet e marra gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare, por edhe pas pushimit të marrëdhënies së punës në afat prej 15 vjetësh.

Në kreun e shtatë, parashihen dispozitat ndëshkimore ku parashihen dënimet me gjobë për rastet kur subjektet kontraktuese me tenderët publikë shkelin rregullat e parapara me ligj.

Në kreun e tetë, përfshihen dispozitat kalimtare dhe të fundit, në të cilat parashihen obligimet e institucioneve ku punojnë personat zyrtarë që të dorëzojnë listën e personave

zyrtarë dhe personave të afërt me ta dhe obligimin e këtyre të fundit që të dorëzojnë informacionet rreth pasurisë së tyre në agjencion.

Sipas vlerësimit të Qeverisë së Kosovës ky projektligji është i rëndësishëm për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

Në përfundim të arsyetimit, ministri Krasniqi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë këtë projektligji.

Pas këtij arsyetimi, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligji i dhanë edhe këta deputetë: **Fatmir Sejdiu, Isajl Kurteshi, Naim Maloku, Fadil Kryeziu, Smajl Latifaj, Haki Shatri, Sebahate Krasniqi, Gani Prekopuca, Ibush Jonuzi dhe Hasan Meta**, që i janë bashkëngjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----63;

Kundër----- 0;

Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin kundër korrupsionit. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komision për Shërbime Publike - Komision raportues- ta shqyrtojnë këtë projektligji në afatin e paraparë dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lojërat e fatit

Kryetari e ftoi sponsoruesin që ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit këtë projektligji.

Ministri Ali Sadria: Për një funksionim më të mirë dhe për një transparencë më të madhe të lojërave të fatit si dhe të vetë Llotarisë së Kosovës, është e nevojshme nxjerrja e ligjit për lojërat e fatit.

Me këtë projektligji lojërat e fatit do të vëhen në sistemin institucional dhe në një mbikëqyrje të përhershme dhe rigoroze të Qeverisë përmes Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Ministrisë për Tregti dhe Industri.

Ky projektligji ka 8 kapituj dhe 63 nene.

Sipas këtij projektligji lojërat me fat janë radhitur në tri grupe: a) lojërat klasike me fat; b) lojërat e veçanta me fat dhe c) lojërat tjera elektronike.

Në kapitullin e dytë, rregullohet veprimtaria e Lotarisë së Kosovës, e cila në përbërjen e saj ka Këshillin drejtues dhe drejtorin. Lotaria e Kosovës do të nxjerr statutin me të cilin do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e Lotarisë së Kosovës.

Në kapitullin e tretë, rregullohen lojërat klasike të fatit. Në këto nene rregullohet llogaria, loto, keno dhe varianta e lojërave të tjera, prognoza sportive, sistemi i automatëve, tv-tombolla, bingo – tërheqja e fitimeve, fondi i fitimeve dhe pagesat e shtypja e tiketave dhe fletëzave të ndryshme.

Në kapitullin e katërt, rregullohen lojërat e veçanta të fatit, si lojërat në kazino, lojërat e automatit dhe klubet e veçanta, basti dhe të gjithë ajo që lidhet me këto lojëra.

Në kapitullin e pestë, rregullohen kompensimet për ushtrimin e lojërave të fatit. Këtu parashihen shuma të pagesës që duhet të bëhen për marrjen e lejes.

Në kapitullin e gjashtë, rregullohet mbikëqyrja e cila do të bëhet nga Minsitria për Ekonomi e Financa.

Në kapitullin e shtatë, përfshihen dispozitat ndëshkimore ku parashihet që subjektet ekonomike që organizojnë lojërat e fatit pa leje, varësisht prej llojit të lojës së fatit, do të gjobiten nga 35.000 deri në 70.000 euro.

Dhe kapitulli i tetë, rregullon dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Në përfundim të arsyetimit, ministri Sadriu karkoi nga deputetët e Kuvendit që ta miratojnë këtë projektligj.

Pas arsyetimit të ministrit Ali Sadria, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur e këtë projektligji i dhanë edhe këta deputetë: Ramadan Kelmendi, Berat Luzha, Naim Maloku, Haki Shatri dhe Hasan Meta, që i janë bashkëngjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----63;

Kundër----- 0;

Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për lojërat e fatit. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Financa dhe Ekonomi - Komision raportues- ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

Seanca e sotme i përfundoi punimet në orën 14:05 minuta.

Vazhdim i seancës më 30 korrik 2004

Seancën e drejtoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit të Kosovë, kurse e ndihmoi **Hydajet Hyseni**, anëtar i Kryesisë.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit këtë projektligj.

Ministrja Resmije Mumxhiu: Kujdesi shëndetësor zbatohet duke u mbështetur në ruajtjen dhe përparimin e gjendjes së tërësishme shëndetësore mbi baza të arritura bashkëkohore mjekësore dhe sigurimit të kushteve për sendërtimin e tyre në praktikë. Janë arritur rezultate të konsiderueshme në përparimin e shëndetit. Megjithatë dhe përkundër këtyre të të arriturave, sektori përballet me një mori vështirësish të natyrës objektive dhe subjektive.

Legjislacioni ekzistues nuk ka siguruar kornizë të qëndrueshme ligjore për ta realizuar këtë qëllim. Si rezultat i kësaj, kemi qenë dëshmitarë të sjelljeve të palejueshme të qytetarëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Njëkohësisht, përgjegjësitë e qytetarëve gjatë këtij procesi nuk kanë qenë qartë të përcaktuara. Kjo ka shkaktuar shpërndarjen e barabart të përgjegjësiave ndërmjet ofruesve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore.

Projektligji do të sigurojë qëndrueshmëri dhe mbështetje për një sistem efikas dhe ligjor në lëmin e respektimit të të drejtave dhe përgjegjësiave të qytetarëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve brenda sektorit të shëndetësisë.

Objektivat e këtij projektligji do të realizohen nëpërmjet:

- a) përcaktimit të të drejtave të qytetarëve në kujdesin shëndetësor, si vijon: e drejta në kujdesin cilësor shëndetësor; e drejta e zgjedhjes; e drejta në dinjitetin njerëzor; e drejta e komunikimit etj.
- b) përcaktimit të përgjegjësiave të qytetarëve në kujdesin shëndetësor si vijon: rrespektimi i dispozitave ligjore në kujdesin shëndetësor; bashkëpunimi i plotë me punëtorët shëndetësorë; respektimi i plotë i të drejtave të qytetarëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor;
- c) sigurimit të zbatimit të të drejtave dhe përgjegjësiave të qytetarëve në kujdesin shëndetësor si vijon: rregullimi i procedurave për ankesa të qytetarëve; definimi i konceptit të dëmit dhe mundësimi i parashtrimt të kërkesave për dëmshpërblim nga ana e qytetarëve; themelimi i komisionit për vlerësimin dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor; përcaktimi i procedurave për kompensimin e dëmit dhe pagesën e dëmshpërblimit.

Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministria e Shëndetësisë duhet të nxjerrë akte dytësore ligjore dhe udhëzime administrative.

Në përfundim ë arsyetim, ministrja Mumxhiu I ftoi deputetët e Kuvendit ta miratojnë këtë projektligj.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe këta deputetë: **Nafie Gash, Naim Jerliu, Zylfie Hundozi, Sejdulah Hoxha, Fetie Këpuska, Nurishahe Hulaj dhe Ramadan Kelmendi**, që I janë bashkëngjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----64;
Kundër----- 0;
Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për të drejtat dhe për përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shëndetësi - Komision raportues- ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet dhe rekomandimet për miratim.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për avokatinë.

Kryetari e ftoi sponsoruesin që ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit këtë projektligj.

Deputetja Nekibe Kelmendi, në emër të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese: Avokatia është shërbim i pavarur, i cili siguron dhënien e ndihmës juridike-profesionale qytetarëve dhe subjekteve të tjera juridike në drejtim të realizimit dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre të bazuara në ligj.

Veprimtaria profesionale e avokatëve nuk përqëndrohet vetëm në mbrojtjen e interesave të klientëve të tyre. Ata janë pjesë e drejtësisë në shoqërinë demokratike.

Instanca rregullative që i rregullon këto vlera në Kosovë, u formua në bazë të ligjit mbi avokaturën të vitit 1973 dhe e cila ende vepron në bazë të këtij ligji. Avokatët janë të organizuar në kuadër të Odës së Avokatëve të Kosovës. Oda e Avokatëve angazhohet në mbrojtjen e rolit të avokatëve në shoqëri dhe në ruajtjen e pavarësisë së profesionit, në ruajtjen dhe mbrojtjen e dinjitetit të pushtetit gjyqësor dhe në garantimin e së drejtës së qytetarëve për t'iu drejtuar drejtësisë dhe sidomos shërbimeve të ndihmës gjyqësore dhe juridike.

Në Kosovë është ende i aplikueshëm ligji mbi avokaturën i vitit 1973.

Ligji mbi avokaturën nuk ka pësuar asnjë ndryshim gjer më tani, në mënyrë që t'i përshtatet rrethanave të reja në Kosovë. Andaj, shumë pjesë të këtij ligji janë të pazbatueshme duke pasur parasysh ndryshimet e gjertanishme të sistemit ekonomik, politik dhe juridik.

Prandaj, është më se e nevojshme të nxirret një ligj i ri, modern – i cili është në pajtueshmëri me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Fusha rregullative e Projektligjit

Në kreun e parë janë të përcaktuara parimet themelore të avokaturës. Për shkak të rëndësisë së posaçme që ka avokatura në shërbim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe forcimit të shtetit ligjor, ushtrimi i profesionit të avokatit, në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare, ajo është e organizuar si një veprimtari private, e lirë dhe e pavarur.

Në kreun e dytë, sanksionohet monopoli i avokatëve në dhënien e ndihmës juridike, me qëllim të garantimit të mbrojtjes së interesave të klientëve dhe të garantimit të institucionalizimit të së drejtës për qasje të barabartë në drejtësi.

Dispozitat mbi kushtet e regjistrimit, kanë për qëllim rritjen e kualitetit dhe profesionalitetit në punë, ruajtjen e prestigjit të avokatit në shoqëri dhe mbrojtjen e interesave legjitime të kërkuesit të këshillës juridike.

Ndër të tjera, është sanksionuar transparenca në punë, shmangia e interesave konfliktuoze, ruajtja e sekretit profesional, mosdiskriminimi në kryerjen e detyrës si dhe dhënie e ndihmës juridike personave që nuk kanë të ardhura.

Projektligji parashikon rregullimin e çështjeve që lidhen me shkaqet dhe motivet për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve, të cilët shkelin ligjin dhe rregullat e etikës profesionale, llojet e masave disiplinore, organin kompetent dhe procedurat përkatëse për marrjen e këtyre masave.

Dispozitat tjera të këtij Projektligji, përmbajnë një numër të konsiderueshëm rregullash që parashikojnë mënyrën e organizimit të veprimtarisë së avokatëve, kompetencat e Odës së Avokatëve dhe organizimin e brendshëm të saj.

Me qëllim të përmbushjes së detyrave të avokatisë, është paraparë edhe monitorimi i veprimtarisë së avoketëve nga ana e strukturave publike, duke mos cenuar vetorganizimin dhe vetëqeverisjen e avokatisë si parim i njohur ndërkombëtar.

Vetëm avokatët e regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës kanë të drejtë për dhënie e ndihmës juridike në Kosovë. Përrjashtim bëhet këtu, në rastet e lidhura me të drejtën ndërkombëtare dhe rastet e paneleve ndërkombëtare ose të përziera në Kosovë.

Në përfundim të arsyetimit, deputetja Nekibe Kelmendi, në emër të Komisionit Legjislativ dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Pas arsyetimit të deputetes Kelmendi, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe këta deputetë: **Gani Koci, Bajram Kosumi dhe Ramadan Kelmendi**, që i janë bashkëngjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----64;

Kundër----- 0;

Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për avokatinë. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komision për Legjislativ - Komision raportues- ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

16. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e prokurorëve dhe të gjykatësve

Kryetari i informoi deputetët për rekomandimin e Komisionit Legjislativ për emërimin e prokurorëve dhe të gjykatësve dhe e hodhi atë në votë. Rezultati ishte si vijon:

Për-----54;
Kundër----- 5;
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurial të Kosovës dhe rekomandimi i Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e prokurorëve dhe të gjykatësve, si vijon:

1. Reshat Millaku, prokuror në Prokurorinë e Kosovës;
2. Shemi Hajdini, prokuror në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë;
3. Muharrem Shabani, gjykatës në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës;
4. Aziz Ramizi, gjykatës në Gjykatën për Kunërvajtje në Gjilan;
5. Vjollcë Jonuzi, gjykatëse në Gjykatën për Kunërvajtje në Gjilan;
6. Musa Shabani, gjykatës në Gjykatën për Kunërvajtje në Shërpcë.

17. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e kryetarit dhe të një anetari në Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik, si dhe të kryetarit dhe të anëtarëve të Agjencisë së Prokurimit Publik

Qeveria e Kosovës e kishte propozuar z. **Ramadan Gashi** në vend të kandidatit të propozuar më herët z. **Bejtush Isufi** për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.

Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se ky është një vendim i Qeverisë dhe dihet se kemi një Qeveri të marrëveshjes dhe të gjitha ato marrëveshje janë bërë në mes të ministrive dhe Qeverisë në përgjithësi. Ne, ose duhet t'i votojmë në paketë, qysh kemi pasë edhe raste të tjera, ose Grupi Parlamentar i PDK-së nuk do të marr pjesë në procesin e votimit.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarit në Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik. Rezultati ishte si vijon:

Për----- shumica;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e emëroi z. **Ramadan Gashi** për anëtar të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik

Pastaj, kryetari e hodhi në votë propozimin e Qeverisë që z. Sejdi Rexhepi të emërohet për kryetar të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së, në shenjë paknaqësie për mënyrën e votimit, e lëshuan seancën.

Në mungesë të kворumit, kryetari dha pauzë gjysëmorëshe.

Pas pauzës, **Kuvendi** e miratoi propozimin e kryetarit që anëtarët e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik t'a emërojnë kryesuesin e përkohshëm të Komisionit nga radhët e vëta, derisa Kuvendi ta emërojë kryetarin e Komisionit.

18. Shqyrtimi i informatës për kërkimin e personave të rrëmbyer dhe të pagjetur

Kryetari e ftoi kryetaren e Komisionit për personat e rrëmbyer dhe të pagjetur ta paraqesë informatën para deputetëve të Kuvendit.

Flora Brovina: Pesë vjet pas përfundimit të luftës, problemi i personave të rrëmbyer gjatë luftës dhe të personave të pagjetur vjen e rëndohet gjithnjë e më shumë. Sepse procesi i kthimit nga varrezat masive të gjetura në Beograd dhe gjetja e tyre në përgjithësi po ngecë, ndërsa procesi i eskumimit dhe i identifikimit si dhe rivarrimi i kufomave të gjetura po shkon shumë ngadalë. Ashtu që edhe më tutje po kërkohet gati i njëjti numër i personave të pagjetur. Familjet e tyre dhe gjithë populli i Kosovës është në ankth dhe pritje të çfarëdo lajmi tjetër.

Rezoluta e miratuar në Kuvendin e Kosovës më 10 prill të vitit të kaluar nga ana e institucioneve tona nuk po zbatohet në përpikëri dhe ashtu siç duhet. Komisioni për Personat e Rrëmbyer Gjatë Luftës dhe Ende të Pagjetur ka patur shumë takime me familjarët dhe në seancat e përjavshme ka diskutuar për problemet e mëdha të familjeve që kanë për personat e zhdukur gjatë luftës. Gjithashtu kemi kontaktuar me organet vendore dhe institucionet ndërkombëtare që janë përgjegjëse për këtë çështje. Çështja e mbrojtjes institucionale, pra e familjeve mbetet gjithnjë problem aktual. Statusi juridik i personave të zhdukur nuk është zgjidhur. Komisioni ynë shpreh brengosje të thellë për procesin e ngadalshëm të identifikimit të kufomave të gjetura në varrezat masive në Serbi, numri i të cilëve tanimë është shumë i madh.

Çështja e personave të zhdukur gjatë luftës është dhe mbetet pjesë e rezervuar e kompetencave të UNMIK-ut dhe kjo është shumë e padrejtë ndaj popullit të Kosovës dhe e paparë në asnjë vend tjetër. Kështu, institucionet vendore privohen nga e drejta për të ditur për çdo gjë për qytetarët e vet, që të marrin pjesë në eskumimin, në identifikime, në pranimm e kufomave, në procesin e informimit të familjeve dhe të tjera. Komisioni parlamentar ishte inisiator dhe tërë kohën insistoi që kjo çështje të jetë në agjendë si pikë e parë për fillimin e bisedimeve me Serbinë. Arritëm që vërtetë kjo kështu të jetë, por ne nuk ishim për biseda teknike.

Çështja e të rrëmbyerve dhe të të zhdukurve gjatë luftës duhet të jetë një çështje transparente dhe reale si për institucionet vendore ashtu edhe për ato ndërkombëtare.

Komisini parlamentar për ta zgjidhur çështjen e personave të rrëmbyer dhe të pagjetur i propozon Kuvendit t'i miratojë këto

REKOMANDIME

1. Të zbatohet me përpikëri Rezoluta e Kuvendit e miratuar më 10. 04. 2003 nga ana e Qeverisë (kryeministrit, Komisionit ndërministror për personat e pagjetur, Grupit për bisedime) nga Presidenca dhe nga institucionet tjera vendore;
2. Të zbatohet secila pikë e Rezolutës, e në veçanti pika numër 4 gjatë bisedimeve;
3. Të insistohet që zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur të jetë transparente me institucionet tona dhe që kompetencat e kësaj zyre të kalojnë tek institucionet vendore dhe ato t'i përgjigjen Parlamentit dhe Qeverisë;
4. Që ekspertët vendor patjetër të marrin pjesë në eskumime, në identifikime dhe në dorëzimin e kufomave;
5. Në bazë të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara dhe në bazë të Konventës së Kryqit të Kuq Ndërkombëtar familjet kanë të drejtë të dijnë çdo gjë për fatin e më të dashurve të tyre. Nëse kanë vdekur ta dijnë shkaku e vdekjes; kush e bëri krimin dhe ku ndodhen varret e tyre?
6. Qeveria duhet të marrë nismën për ngritjen e aktakuzës kundër Serbisë dhe Millosheviqit e bashkëpunëtorëve të tij për gjenocid;
7. Të insistohet që familjarët të bëjnë kallzime penale në kuadër të prokurorive komunale dhe për të gjitha rastet që kanë dëshmi dhe argumente;
8. Çështja e personave të rrëmbyer dhe të zhdukur gjatë bisedimeve me Serbinë të trajtohet si çështje humanitare dhe juridike;
9. Mbështesim kërkesën e qytetarëve të nënshkruar me peticion dhe insistojmë në zbardhjen e fatit të të rrëmbyerve dhe të pagjetur, pa kushte;
10. Insistojmë tek institucionet vendore që të realizojnë mbrojtjen institucionale të familjeve të të rrëmbyerve dhe të pagjeturve;
11. Të rregullohet statusi juridik i personave të rrëmbyer gjatë luftës dhe ende të pagjetur;
12. Kërkojmë sqarime lidhur me ngecjen e fillimit të punimeve të Institutit Mjeko-ligjor në Prishtinë;
13. Insistojmë në zbatimin e standardeve të praktikës së suksesshme në zbulimin, ekzaminimin dhe identifikimin e eshtrave të zbuluara;
14. Insistojmë në lëshimin e dokumentacionit komplementar në lidhje me rrethanat e rrëmbimit dhe të zhdukjes, për shkaku e vdekjes, kush e shkaktoi vdekjen, kohën e ekzekutimit dhe kohën e eskumimit si dhe konditat tjera;
15. Insistojmë që institucionet vendore të informohen me kohë dhe të jenë pjesë e procesit të riatdhesimit të kufomave të gjetura në Serbi, të informimit të familjeve dhe varrimit me mbikëqyrje dhe përkujdesje institucionale;
16. Insistojmë të zbatohet pika 10 e Rezolutës me përpikëri, domethënë të formohet arkivi i posaçëm për persona të rrëmbyer e të zhdukur gjatë luftës dhe ende të pagjetur;
17. Kërkojmë ndihmë nga Kombet e Bashkuara, nga Bashkimi Evropian, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shtetet e Quintit që të bëjnë më shumë presion tek ata që

duhet të zbardhin fatin e personave të rrëmbyer gjatë luftës dhe ende të pagjetur në Kosovë.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e çështjes së personave të rrëmbyer gjatë luftës dhe që ende nuk janë gjetur dhe sugjerimet lidhur kërkimine personave të rrëmbyer dhe të pagjetur i dhanë edhe këta deputetë: **Sanie Alaj, Berat Luzha, Mevlyde Saraçi, Bajram Kosumi, Smajl Latifaj dhe Shefki Sejdiu**, që i janë bashkëngjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **Kuvendi** nxori këtë

Përfundim:

1. Ngarkohet Komisioni për Personat e rrëmbyer dhe të pagjetur, në bazë të diskutimeve të deputetëve, t'i hartojë rekomandimet lidhur me kërkimin e personave të rrëmbyer dhe të pagjetur dhe t'ia paraqes Kuvendit për miratim.

19. Shqyrtimi i vendimit të Panelit të posaçëm lidhur me kundërshtimin e koalicionit "Kthimi" të Ligjit për shëndetësi

Kryetari i informoi deputetët për vendimin e Panelit të posaçëm lidhur me kundërshtimin e koalicionit "Kthimi" të Ligjit për shëndetësi. Dhe e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij.

Pas diskutimeve të **Alush Gashit, Sejdullah Hoxhës, Bajram Kosumit dhe Gani Sadik** (i janë bashkëngjitur transkriptit), kryetari e hodhi në votë vendimin e Panelit të posaçëm lidhur me Ligjin për shëndetësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër----- 4;
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash i miratoi pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6 të vendimit të Panelit të veçantë lidhur me Ligjin për shëndetësi, kurse i refuzoi pikat 1 dhe 7 të tij.

20. Shqyrtimi i vendimit të Panelit të posaçëm lidhur me kundërshtimin e koalicionit "Kthimi" të Ligjit kundër diskriminimit

Kryetari i informoi deputetët për vendimin e Panelit të posaçëm lidhur me kundërshtimin e koalicionit "Kthimi" të Ligjit kundër diskriminimit dhe e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij.

Pas diskutimeve të **Alush Gashit, Hydajet Hysenit, Bajram Kosumit dhe Hasan Metës** (i janë bashkangjitur transkriptit), kryetari e hodhi në votë vendimin e Panelit të posaçëm lidhur me Ligjin kundër diskriminimit. Rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër----- 5;
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi vendimin e Panelit të posaçëm lidhur me Ligjin kundër diskriminimit.

Kryetari e deklaroi të përfunduar seancën plenare në orën 13:05 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat DACI